



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

NJOFTIM
PËR SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E
GJYQTARËVE
PËR KOMANDIMIN NË POZICIONIN E NDIHMËSMAGJISTRATIT NË
GJYKATËN KUSHTETUESE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 8, 53, 54, 56, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, me vendimin nr. 381, datë 17.07.2023 ka vendosur:

“Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Kushtetuese për 3 (tre) pozicione “ndihmësmagjistratit” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese.”

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim.

Kohëzgjatja e komandimit është 3 (tre) vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
- d) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
- e) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;

Kushtet e komandimit janë:

- a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:

- i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
- ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
- d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- dh) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, sekretarin e përgjithshëm, anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteret preferenciale të komandimit janë:

- a) Përvoja profesionale minimale prej 1(një) viti dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;
- b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;
- c) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;
- ç) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- d) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsytimit ligjor;
- dh) Aftësi shumë të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- e) specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 31.07.2023.

Dokumentacioni i aplikimit (Kërkesa për komandim dhe Vetëdeklarimet) duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Rruga “Ana Komnena”, ndërtesa “Poli i Drejtësisë” Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me **Vendimin nr.381, datë 17.07.2023**, “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese

17.07.2023